

VENDIM
Nr. 191, datë 18.10.2024

**PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË,
Z. ERJON SHËRBET MEKA, KANDIDAT I LISTËS SHUMEMËRORE TË PARTISË
SOCIALISTE TË SHQIPËRISË, QARKU DURRËS, PËR ZGJEDHJET PËR
KUVEND, TË DATËS 25 PRILL 2021**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronjat “i”, “n” e 2, 163 pika 7, 164 pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, dhe të kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, ‘Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike’”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 3793/1 prot., datë 17.10.2024, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, nga z. Jurgis Shefqet Çyrbja, i zgjedhur në zonën zgjedhore, qarku Durrës, propozuar nga “Partia Socialiste e Shqipërisë”.

Partia Socialiste e Shqipërisë është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, me vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 69, datë 15.2.2021, Komisioni Rregullator me vendimin nr. 21, datë 13.7.2021, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të zhvilluara më datë 25.4.2021.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nëpërmjet vendimit nr. 408, datë 23.6.2021, miratoi shpërndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore, përcaktimin e kandidatëve fitues, si dhe rirenditjen e kandidatëve të cilët nuk kanë përfutur mandat në bazë të numrit të votave parapëlqyese në zonën zgjedhore, qarku Durrës, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të datës 25.4.2021.

Sipas këtij vendimi, Partia Socialiste e Shqipërisë, për zonën zgjedhore, qarku Durrës, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të datës 25 prill 2021, ka fituar 8 (tetë) mandate.

Rezulton se lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, në zonën zgjedhore, qarku Durrës, i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë.

Zëvendësimi i vakancës do të bëhet në mbështetje të nenit 164, pika 2, të Kodit Zgjedhor, si dhe vendimit nr. 408, datë 23.6.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në të cilin është miratuar rirenditja e kandidatëve, të cilët nuk kanë përfutur mandat në bazë të numrit të votave parapëlqyese.

Sipas këtij vendimi, rezulton se kandidati të cilit i kalon mandati i deputetit, është kandidati me numër rendor 11 (njëmbëdhjetë), z. Erjon Shërbet Meka.

Me shkresën nr. 3010 prot., datë 17.10.2024, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidati për deputet, të Partisë Socialiste të Shqipërisë, në zonën zgjedhore, qarku Durrës, z. Erjon Shërbet Meka, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për Kuvendin të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant.

Kandidati për deputet, z. Erjon Shërbet Meka, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër 24077 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i deputetit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile, si dhe nga zyra e gjendjes gjyqësore për z. Erjon Shërbet Meka, si dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë, për verifikimin e të dhënave për kandidatin për deputet, në zonën zgjedhore, qarku Durrës, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, z. Erjon Shërbet Meka.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për deputet, në zonën zgjedhore, qarku Durrës, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, z. Erjon Shërbet Meka, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Pas verifikimeve të kryera, referuar pikës 2, të kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit konstatohet se të dhënat e kandidatit për deputet, në zonën zgjedhore, qarku Durrës, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, z. Erjon Shërbet Meka, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e deputetit në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i deputetit z. Jurgis Shefqet Çyrbja, i përket kandidatit vijues në listën shumemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, në zonën zgjedhore, qarku Durrës i renditur me numër rendor 11 (njëmbëdhjetë), z. Erjon Shërbet Meka,

PËR KËTO ARSYE,

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronjat “i”, “n” e 2, 163, pika 7, 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, dhe në kreun V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, ‘Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike’”,

VENDOS:

1. Dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, në zonën zgjedhore, qarku Durrës, z. Erjon Shërbet Meka.

2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE
Ilirjan Celibashi